



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen të gjeturat e Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2018.
2. Obligohen Institucionet kompetente për zbatimin e rekomandimeve të dala nga Raporti.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit sipas imputeve të marra nga Institucionet kompetente të hartoj Raport Tremujor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga ky Raport.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/94
Datë: 19.03.2019


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikeë së Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M
Për themelimin e Këshillit Statistikor

1. Këshilli Statistikor (Këshilli), përbëhet nga këta përfaqësues të institucioneve përkatëse:
 - 1.1. Isa Krasniqi - Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së;
 - 1.2. Behxhet Haliti - Përfaqësues i Ministrisë së Financave;
 - 1.3. Vedat Maçastena - Përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
 - 1.4. Enver Mekolli - Përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 1.5. Merita Berisha - Përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë;
 - 1.6. Vedat Sagonjeva - Përfaqësues i Zyrës për Planifikim Strategjik - ZKM;
 - 1.7. Bedri Zymeri - Përfaqësues i Bankës Qendrore të Kosovës;
 - 1.8. Agron Hamiti - Përfaqësues i Administratës Tatimore të Kosovës;
 - 1.9. Mentor Morina - Përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.10. Delvina Hana - Përfaqësuese e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - 1.11. Rahmije Mustafa - Topxhiu - Përfaqësuese e Universitetit.
2. Në takimin e parë, Këshilli vendosë për përfaqësuesin e qendrave kërkimore dhe të komunitetit të biznesit.
3. Këshilli vepron në bazë të Rregullave Procedurale, të cilat miratohen nga Këshilli brenda tre (3) muajve pas themelimit të Këshillit.
4. Këshilli emëron kryesuesin dhe një zëvendës kryesues nga radhët e anëtarëve të tij.
5. ASK-ja mbështet teknikisht dhe përmes administratës veprimtarinë e Këshillit.
6. ASK-ja financon aktivitetet e Këshillit nga buxheti i vet.
7. Këshilli kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Rregullat përkatëse Procedurale, të cilat miratohen nga Këshilli.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/94
Datë: 19.03.2019


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 06/71 të datës 23 tetor 2019

1. Vendimit të Qeverisë Nr. 06/71 të datës 23 tetor 2018, i hiqet pika 3. *"Ndërtesës i ruhet pamja e jashtme në pajtim me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore"*.
2. Pjesa tjetër e Vendimit Nr. 06/71 mbetet e pandryshuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës për publikimin e veçantë në formë të shtypur në shkrimin brail, të legjislacionit të publikuar në Gazetën Zyrtare, i përzgjedhur pjesërisht me qëllim të ofrimit të qasjes në informim për personat e verbër.
2. Obligohet Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare, Zyra Ligjore në kuadër të ZKM-së, që në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës, për çdo tre muaj, të përzgjedhin pjesërisht legjislacionin relevant të publikuar në Gazetën Zyrtare, që të shtypet në shkrimin brail në ekzemplarë të caktuar sipas nevojave të personave të verbër në Republikën e Kosovës dhe në pajtim me ndarjet buxhetore të parapara për vitin kalendarik.
3. Shtypja dhe publikimi në alfabetin brail sipas pikës 1. të këtij Vendimi, bëhet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për prokurimin publik.
4. Mjetet financiare në shumë prej 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) euro për zbatimin e këtij vendimi janë të ndara në kategorinë mallra dhe shërbime në Programin 10600 në Zyrën e Kryeministrit.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 05/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 06/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2019 - 2023.
2. Buxheti për zbatimin e këtij Programi mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2019 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Integrimit Evropian dhe institucionet e tjera përgjegjëse, sipas Programit.
4. Obligohet Ministria e Integrimit Evropian të inkorporojë në Program të gjitha komentet e Komisionit Evropian.
5. Obligohet Ministria e Integrimit Evropian që gjatë vitit 2019 të inkorporojë në Program veprimet pasuese të dala nga konkluzionet e takimeve të raundit të dytë të organeve të Stabilizim-Asociimit të themeluara me MSA.
6. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të përcjellë këtë Program për aprovim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi 2019-2023 dhe Plani i veprimit 2019-2021.
2. Obligohet Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Caktimin e Kërkesave, Kushteve dhe Procedurave për Krijimin e Numrit Unik Identifikues.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 09/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Kinematografinë.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 10/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave dhe Qeverisë së Zvicrës, përfaqësuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme, përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim për bashkëfinancim të granteve të komunave sipas performancës komunale.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave obligohen që të procedojnë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 11/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Pasqyra financiare preliminare për ekzekutimin e buxhetit dhe bilanci i fondeve për vitin 2018.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që materialin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për informim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për zotimin e mjeteve financiare në shumë prej 500,000 (pesëqind mijë) euro për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit për mbrojtjen e interesave të Republikës së Kosovës në rastin e Arbitrazhit ICSD nr. ARB/17/25.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 08/80 të datës 18 dhjetor 2018

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë Nr. 08/80 i datës 18 dhjetor 2018, pas pikës 4, shtohet pika si në vijim:

4/A. Autorizohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin e kontratës nga pika 2 e Vendimit.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/94
Datë: 19.03.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 40,000 (katër dhjetë mijë) euro për përkrahje financiare për z. Lahi Brahimaj i akuzuar potencial në procesin gjyqësor pranë Dhomave të Specializuara.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezerva Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232-13100 nga kategoria e shpenzimeve të rezervës.
3. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi transferohen në Ministrinë e Drejtësisë me kod 215, nën programi Mbrojtja Juridike dhe Mbështetja Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara me kod 37900, kategoria e shpenzimeve subvencionet dhe transferet.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë